

## Termt e Referencës për studentët pjesëmarrës të AASA '17

**Qëllimi:** “Akademia Verore AA'17”, zhvillohet në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe procesit të planifikimit vendor të Bashkive Këlcyrë, Kolonjë dhe Përmet, me fokus në Luginën e Vjosës dhe qëllim nxjerrjen në pah të potencialeve turistike të kësaj lugine dhe evidentimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme që mund të zhvillohen në këtë territor për të rritur ardhjet e vizitorëve në luginë dhe për shfrytëzimin me efikasitet e përgjegjësi të potencialit natyror turistik që ofron natyra dhe kultura vendase.

**Kriteret e Pranimit:** Studentët pjesëmarrës në AASA '17 do të përzgjidhen nëpërmjet një procesi, i cili do të kalojë në dy faza:

- **Faza e parë:** përzgjedhja e disa aplikantëve bazuar në shqyrtimin e dokumenteve që ata kanë paraqitur gjatë fazës së aplikimit (14 qershor – 5 korrik). Dokumentet që do të kërkohen në fazën e aplikimit janë portfolio dhe CV.
- **Faza e dytë:** Aplikantët e përzgjedhur gjatë fazës së parë do të kalojnë përmes një sesioni intervistash (5 – 26 korrik) ku do të përzgjidhen pesë studentë që do të jenë pjesë e AASA '17 (aftësitë e komunikimit në gjuhën angleze do të vlerësohen gjatë kësaj faze).

**Metodologjia:** Skuadra e Akademisë Verore (udhëheqësi i Akademisë, asistenti i projektit dhe pesë studentë) do të zhvillojnë një studim kërkimor prej pesë javësh gjatë së cilit do të eksplorojnë potencialet turistike të Rajonit. Puna kërkimore do të ndahet në: dy javë në terren dhe tre javë në Tiranë, sipas progamit të mëposhtëm:

### Java 1\_vizitë në terren:

- Kjo periudhë do të shpenzohet në vendndodhje kyçe të përcaktuara përpara nisjes. Do të kryhen vëzhgime, dokumentime si edhe do të identifikohen kontakte vendase me rëndësi.
- Kategorizimi i vendbanimeve për veçoritë pozitive: aksesibiliteti, prania e kulturës vendase, pasuritë natyrore, etj.

### Java 2\_vizitë në terren:

- Gjatë kësaj periudhe, pas konsolidimit të informacioneve bazë gjatë javës së parë, do të marrin jetë propozimet e para.
- Cikli i dytë i vëzhgimeve.
- Diskutime me aktorët kyç mbi projekt-idetë dhe gjetjet.

### Java 3\_Tirana

- Strukturimi i skuadrës për dokumentimin dhe përpunimin e materialeve bruto.
- Përforcimi i informacioneve të mbledhura, duke krijuar bazat e para të projekt-ideve.
- Nis puna për ideimin e përmbajtjes së botimit.

## Java 4\_Tirana

- Konsultime me profesionistë/ekspertë të planifikimit.
- Interpretimi i të dhënave.
- Vijnë puna për përgatitjen e materialeve për botimin.

## Java 5\_Tirana

- Perpunimi i mëtejshëm i projekt-ideve.
- Konkluzionet dhe finalizimi i materialeve që do të përfshihen në botim.

### Skudra do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- **Gjetje e informacioneve në terren:** Gjatë fazës së parë studentët e akademisë do të mbledhin të dhënat me qëllim evidentimin e potencialeve turistike të rajonit.
- **Hartimi i projekt-ideve:** Të përzgjedhurit do të interpretojnë të dhënat e mbledhura në terren si dhe do t'i përpunojnë ato për publikim. Këto materiale janë në trajtë teksti dhe përpunime grafike.
- **Të kryejnë** të gjitha detyrat e caktuara nga udhëheqësi i Akademisë dhe asistenti, të cilat janë në funksion të qëllimit të Akademisë dhe objektivave të saj.

### Zona në Studim: Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë

**Produkti Përfundimtar:** Produkti përfundimtar i Akademisë Verore AA '17 do të vijë në trajtën e një botimi, i cili do të mbështetet në këto dy pika kryesore:

- a. Krijimin e një rrjeti aktivitetesh kulturore e turistike, për tërheqjen e vizitorëve dhe gjallërimin e potencialit turistik të luginës, në çdo stinë.
- b. Krijimin e një 'buqete' me projekt-ide për ndërhyrje pikësore me karakter pejsazhistik, për evidentimin e tipareve karakteristike të luginës.

FALEMINDERIT!  
SUKSESE!

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit  
**Atelier Albania**